

VENDIM
Nr.498, datë 6.7.2010

**PËR SHPËRBLIMIN E NJË PUNONJËSI POLICIE, NË DEPARTAMENTIN PËR HETIMIN
E KRIMEVE, NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, të z.Bujar Hoxha, për punën e shkëlqyer, përkushtimin, vetëmohimin dhe skarifcën e treguar gjatë kryerjes së detyrës, duke vënë në rrezik jetën.

2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për shpërblimin e punonjësit të policisë, z.Bujar Hoxha.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha